




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 9 pika 2 të Ligjit Nr.04/L-016 për Eficiencën e Energjisë, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Shërbime Publike, Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 29.09.2014 miraton këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
2014-2020

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Planin Komunal për Eficiencë të Energjisë 2014-2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2014-2020 i hartuar nga Komisioni Komunal për Eficiencë të Energjisë i formuar nga Kryetari i Komunës me vendimin 02.Nr.02/138 të datës 03.03.2014
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan dhe Drejtoria për Shërbime Publike, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 016-112984
Gjilan, më 29.09.2014

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi,